

Nr. K1/I18-5 Prot.
Nr. Dok. 202502426/5

Tiranë 04.11.2025

Lënda: Rekomandohet marrja e masave për zbatimin efektiv dhe transparent të skemës “Aboneja e Pensionistit” në Tiranë

BASHKISË TIRANË

Për dijeni:

KËSHILLI BASHKIAK, BASHKIA TIRANË

PREFEKTI I QARKUT TIRANË

**MINISTRI I SHTETIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTI-KORRUPSIONIN**

MINISTRI I SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ka filluar me iniciativë një hetim administrativ lidhur me procesin e shpërndarjes së “Abonesë së Pensionistit” në Tiranë, pas shqetësimeve të vazhdueshme të bëra publike në mediat investigative¹ lidhur me rradhët e gjata dhe vështirësitë e panevojshme procedurale me të cilat ndeshen pensionistët në marrjen e shërbimit. Ndërsa Bashkia Tiranë ka deklaruar publikisht shtimin e pikave të shpërndarjes, Shoqata e Transportit Urban ka pohuar se numri real i

¹ <https://faktoje.al/a-mjaftojne-8-pika-ne-tira-dtne-per-terheqjen-e-aboneve-nga-pensionistet/>

pikave mbetet i pandryshuar, me vetëm tetë pika në të gjithë kryeqytetin. Në të njëjtën kohë, një kërkesë e qartë e pensionistëve është shtrirja e vlefshmërisë së abonimit në 6 muaj ose një vit, për të shmangur paraqitjen e përmuajshme.

Në këtë kuadër, për qëllime të hetimit administrativ dhe vlerësimit të këtij rasti, Avokati i Popullit iu drejtua zyrtarisht Bashkisë Tiranë me shkresat nr. 202502426/2, dt. 17.03.2025, nr. 202502426/3 dt. 08.05.2025, si dhe nr. 202502426/4, dt. 29.07.2025 në të cilat është parashtruar në mënyrë të përsëritur kërkesa për një informacion të plotë, gjithëpërfshirës dhe konkret lidhur me problematikën e mesiperme, bazuar në detyrimin kushtetues të organeve publike për t'i vënë në dispozicion Avokatit të Popullit dokumentet dhe të dhënat e kërkuara, si dhe në të drejtën tonë ligjore për të marrë çdo material të lidhur me hetimin. Megjithatë, nga Bashkia Tiranë **nuk është përcjellë asnjë përgjigje zyrtare lidhur me këtë çështje.**

Në këto kushte, Avokati i Popullit vlerëson të adresojë rastin nëpërmjet këtij rekomandimi, për sa vijon.

Me vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 125, datë 19.11.2024, u vendos nisma për përcaktimin e tarifave të transportit qytetas dhe mënyrën/rregullat e kompensimit e subvencionimit, duke përfshirë Abonenë e Pensionistit dhe Abonenë e Studentit të kompensuara plotësisht, si edhe subvencionimin deri në 10 lekë për biletën njëpërdorimshme. Ky është një vendim i lavdërueshëm që ndikon në përmirësimin e cilësisë së jetës së studentëve dhe pensionistëve. Ndërkohë me vendimin nr. 131, datë 18.12.2024, u miratua PBA 2025-2027 dhe detajimi i buxhetit 2025, duke garantuar bazën financiare për zbatimin nga 1 janari 2025 të kësaj nisme sociale. Megjithatë, nga këto akte rezulton se ato janë të natyrës kornizë financiare dhe rregullatore dhe nuk parashikojnë modalitetet praktike të shpërndarjes (numrin/shtrirjen e pikave, kanale alternative shpërndarje, apo kohëzgjatjen e vlefshmërisë). Ndaj, qëllimi i hetimit administrativ ka qenë ndër të tjera, të evidentohet nëse, përveç vendimeve kuadër nr. 125, datë 19.11.2024 dhe nr. 131, datë 18.12.2024, ekziston një akt i posaçëm i miratuar që rregullon modalitetet teknike të zbatimit të skemës, si numri dhe shtrirja gjeografike e pikave të shpërndarjes, kanalet alternative të pajisjes, mënyra e verifikimit dhe kohëzgjatja e vlefshmërisë së abonesë.

Së pari, edhe një herë dëshirojmë të theksojmë se Avokati i Popullit e vlerëson skemën e “Abonesë së Pensionistit” si një mjet të rëndësishëm të politikave sociale të bashkisë dhe operatorëve të transportit publik. Lehtësimi ekonomik për të moshuarit, si grup i mbrojtur, është një praktikë që meriton të përshëndetet, të ruhet dhe të forcohet.

Megjithatë, mënyra e zbatimit aktual, me vlefshmëri abonimi vetëm 1 mujor dhe me numër të kufizuar pikash, ka krijuar pengesa jo të përshtatshme për përfituesit, duke ulur nivelin e sadisfaksionit, veçanërisht tek ata me lëvizshmëri të kufizuar, me sëmundje kronike ose që jetojnë larg pikave ekzistuese. Radhët e gjata në ditët e para të muajit, flukset e pamenaxhuara dhe mungesa e kanaleve alternative e kthejnë një të drejtë sociale në pengesë praktike. Sado e mirë të jetë nisma, pa një kornizë të plotë zbatimi ajo mbetet vetëm në letër; një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut kërkon që politikën, veçanërisht ato sociale në nivel vendor, të ndërtohen me ligjshmëri, pjesëmarrje kuptimplotë të grupeve të prekura (si titullarë të të drejtave), mosdiskriminim e akses universal, dhe llogaridhënie të qartë të mbajtësve të detyrimeve. Vetëm kështu nisma përkthehet në përfitime reale, të barabarta dhe të qëndrueshme, duke respektuar dinjitetin, autonominë dhe interesin më të mirë të qytetarëve të cilëve ajo synon t’u shërbejë. Vetëm kështu arrihet plotësisht objektivi i politikës sociale të lavdërueshme.

Së dyti, mungesa e përgjigjes nga ana e Bashkisë Tiranë ndaj tri kërkesave tona për informacion përbën një tjetër shqetësim institucional për Avokatin e Popullit. Mungesa e komunikimit nga ana e Bashkisë Tiranë me Avokatin e Popullit nuk është rast i izoluar, por një shqetësim i përsëritur që evidentohet sa herë ky institucion i drejtohet bashkisë me kërkesa për informacion dhe shpjegime; në rastin konkret, siç e theksuam më herët, pavarësisht tre kërkesave tona zyrtare (nr. 202502426/2, datë 17.03.2025; nr. 202502426/3, datë 08.05.2025; dhe nr. 202502426/4, datë 29.07.2025), Bashkia Tiranë ka zgjedhur heshtjen administrative, duke mos dhënë asnjë përgjigje.

Avokati i Popullit, si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave të njeriut dhe mbrojtës i qytetarëve përballë autoriteteve publike dhe subjekteve që veprojnë për llogari të tyre, është përpjekur të ushtrojë funksionin e tij ligjor në këtë çështje, por është ndeshur me refuzim për bashkëpunim dhe mosdhënie informacioni.

Ky qëndrim bie hapur ndesh me:

- pikën 4 të nenit 63 të Kushtetutës (“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”);
- nenin 19/b të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, që i njeh Avokatit të drejtën të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore e vendore dhe të marrë çdo dosje apo material që lidhet me hetimin, si edhe të caktojë afate për kryerjen e veprimeve;
- parimet e ligjshmërisë, transparencës, informimit, ndihmës aktive, drejtësisë e paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efikasitetit, sipas neneve 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15 dhe 18 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Për më tepër, në rastin konkret bëhet fjalë për një çështje veçanërisht të ndjeshme, që prek drejtpërdrejt të drejtën e qytetarëve të moshuar për akses efektiv në shërbimin e transportit publik të subvencionuar nga shteti. Kur informacionet mbi mënyrën e pajisjes me abonë, pikat e shpërndarjes, afatet e vlefshmërisë dhe masat për menaxhimin e flukseve janë të qarta e të aksesueshme, pensionistët kuptojnë të drejtat e tyre, ulen radhët dhe shmangen kostot e panevojshme në kohë e stres; transparenca në këtë drejtim ndërton besim dhe zvogëlon hapësirën për abuzime apo trajtim të pabarabartë. Refuzimi i vazhdueshëm i Bashkisë Tiranë për të bashkëpunuar dhe për të ofruar informacionin e kërkuar ka krijuar një klimë mosbesimi dhe pasigurie, zhvlerëson përpjekjet institucionale për garantimin e së drejtës për shërbim publik cilësor dhe e zbeh efektivitetin e një nisme sociale me impakt të drejtpërdrejtë të një grup i mbrojtur. Ky qëndrim është i papranueshëm dhe në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe etikën e funksionimit normal të administratës publike, duke cenuar jo vetëm llogaridhënien ndaj qytetarëve, por edhe ushtrimin e mandatit kushtetues të Avokatit të Popullit.

Në dritën e gjetjeve të mësipërme, Avokati i Popullit vlerëson se zbatimi i skemës “Abonja e Pensionistit” në Tiranë mbështetet kryesisht në akte kuadër (VKB nr. 125, datë 19.11.2024 dhe VKB nr. 131, datë 18.12.2024), pa një akt të posaçëm zbatues që të rregullojë modalitetet teknike (numrin/shtrirjen e pikave, kanalet alternative të pajisjes, mënyrën e

verifikimit dhe kohëzgjatjen e vlefshmërisë), çka ka prodhuar pengesa faktike dhe rrezik trajtimi të pabarabartë për të moshuarit. Mungesa e përgjigjes nga Bashkia Tiranë ndaj kërkesave zyrtare të Avokatit të Popullit përbën zvarritje administrative dhe cenon transparencën e detyrueshme, duke minuar llogaridhënien ndaj publikut.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 1 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (*“Të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta në dinjitet dhe në të drejta”*), në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës (*“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*) dhe në vijim të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar (*“Pas përfundimit të hetimit... paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje...”*),

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme nga Bashkia Tiranë për të miratuar dhe publikuar aktet zbatuese me masa praktike të përshtatura me nevojat reale të qytetarëve, duke vënë në themel të këtyre praktikave parimin e aksesit universal, duke mundësuar një shërbim realisht të aksesueshëm për kategoritë objekt trajtimi në këtë rekomandim.
2. Marrjen e masave nga Bashkia Tiranë për identifikimin pa vonesë të personave përgjegjës për mosbashkëpunimin me Avokatin e Popullit, si dhe marrjen e masave administrative përkatëse që shkelje të tilla të mos përsëriten.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se: *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*, lutemi, pas shqyrtimit, të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA

d.v.